

L I G J
Nr.7933, datë 17.5.1995

PËR PUNËT PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Familjeve me ndihmë ekonomike u ofrohet pjesëmarrja në punët publike për anëtarët e tyre.

Neni 2

Punët publike, në kuptimin e këtij ligji, janë punë të përkohshme që realizohen me pjesëmarrjen e anëtarëve të familjes përfituese të ndihmës ekonomike dhe organizohen nga shteti për ndërtim elementesh të thjeshta të infrastrukturës, riparime, pastrime dhe mirëmbajtje objektsh të ndryshme.

Neni 3

Familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, anëtarët e të cilave refuzojnë pjesëmarrjen në punët publike të ofruara, u ndërpritet ndihma ekonomike.

Neni 4

Përcaktimi i pagës, koha e punës dhe sigurimi shoqëror i personave pjesëmarrës në punët publike, rregullohen në bazë të kontratave të lidhura ndërmjet punëdhënësve dhe pjesëmarrësve në punët publike.

Neni 5

Këshilli i Ministrave përcakton kriteret e organizimit të punëve publike dhe mënyrën e financimit të tyre.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1107, datë 30.5.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha